



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.733/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdi Haziri anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me apelin e Besarta Meha, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Skenderaj, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, paraqitur kundër vendimit Nr.2232-2017 të datës 08.11.2017, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shpalljen e rezultateve përfundimtare për Kuvendet Komunale, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET si i bazuar apeli i Besarta Meha, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Skenderaj, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal në Skenderaj, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj në Vendvotimet: 2121B/ 02D, 2121B/ 02R, 2121B/ 01R.

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutit e Vendvotimeve si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datë 09.11.2017, nga Besarta Meha, kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal në Skenderaj, nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, dega në Skenderaj, me të cilën pretendon se ka pasur parregullsi gjatë numërimit të votave në vendvotimet 2121B/ 02D, 2121B/ 02R, 2121B/ 01R, në fshatin Abri e Poshtme të Komunës së Skenderajt, po ashtu ka theksuar se ka edhe dëshmitar të cilët kanë qenë në ato vendvotime të cilët I kanë vërejtur ato parregullsi.

Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur disa deklarata të dëshmitarëve lidhur me rastin në fjalë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe shkresat e tjera si dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

Apeli është i bazuar

Paneli gjeti se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara, për faktin se nga dëshmitë e ofruara nga apeluesja që gjenden në shkresat e lëndës ka vlerësuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura me vendimin e KQZ-se me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit për vendvotimet e cekura ne piken II te dispozitivit te këtij vendimi, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal në Skenderaj nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, për vendvotimet e lartcekura, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim te përfshihet ne rezultatit përfundimtar te zgjedhjeve.

Prandaj, PZAP-it me qëllim të evitimit të lëshimeve të lartë cekura vendosi si ne piken II te diapozitivit te vendimit duke u bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL.A.nr.733/2017 me datë 12.11.2017



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.